



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 04.07.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Miratimi i procesverbalit.

Shqyrtimi i projektligjit “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Eficienca energjetike përmes sektorit bankar” ratifikuar me ligjin nr.89/2015”” (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Florjon Mima, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Tatjana Nurçe, Lorenc Luka, Robert Bitri, Edmond Leka, Vullnet Sinaj, Klevis Balliu dhe Romeo Gurakuqi.

Mungojnë:

Eglantina Gjermeni, Hekuran Hoxhalli, Dritan Bici, Lefter Koka dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Ilir Bejtja – Këshilltar i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjetikës

Enea Karakaci – Drejtor Juridik në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës

Ilir Halilaj – Zëvendësministër i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Elma Vathi – Specialiste e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Ditën e sotme kemi shqyrtimin e projektligjit “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Eficienca energjetike përmes sektorit bankar”, i ratifikuar me ligjin nr.89/2015”.

Kemi të ftuar nga Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës, zotin Bejtja dhe drejtorin juridik, Enea Karakaçi; nga Ministria e Bujqësisë kemi zëvendësministrin Ilir Halilaj, specialisten Elma Vathi, të cilëve u uroj mirëseardhjen në komision.

Pa humbur kohë, do të doja t’u jepja fjalën përfaqësuesve të ministrisë të na shpjegojnë kontekstin: përse kemi ardhur në këtë pikë; përse e miratuam në vitin 2015 dhe përse po e anulojmë?

Ilir Bejtja – Përshëndetje të gjithëve.

Në fillim po bëj një panoramë të përgjithshme të situatës dhe pastaj do të sqaroj se përse kemi ardhur me këtë propozim.

Në vitin 2015 është ratifikuar në Kuvend ligji 89/2015, që ishte një marrëveshje midis Republikës së Shqipërisë dhe KfV-së për financimin e bankave të nivelit të dytë për dhënien e kredive të buta në sektorin e eficiencës së energjisë. Në fakt, kjo marrëveshje ishte një hua e butë me vlerë 12 milionë euro, që parashikohej të alokohej ndërmjet bankave të nivelit të dytë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që kërkonin të bënin financimin në sektorin e eficiencës së energjisë. Gjatë këtyre viteve është konstatuar se kjo nismë nuk ka qenë e suksesshme. Edhe nga komunikimi që kemi pasur me ambasadën gjermane, le të themi se arsyeja e konstatuar për mos dhënien e kredive, nuk ishte mungesa e likuiditetit të bankave, që kanë nevojë që të injektohen me hua nga KfV-ja, por ishte mungesa e garancive nga kredimarrësit. Në fund të vitit 2017 dhe në fillim të vitit 2018 janë bërë takime të shpeshta me përfaqësues të KfV-së, Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Bujqësisë, Ministrisë së Financave dhe me ministrinë përgjegjëse për energjinë dhe është vlerësuar se do të ishte më e suksesshme që kjo hua të denoncohej, meqenëse fondi nuk është lëvruar dhe alokuar, dhe të zëvendësohej me një marrëveshje tjetër të KfV-së për Ministrinë e Bujqësisë (që në dijeninë time duhet të jetë në rend të ditës këto ditë në Kuvend), ku t’i alokohej një grant prej 5 milionë eurosh, që do të shërbente si garanci për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që të merrnin kredi në sektorin e bujqësisë.

Si e tillë, në bashkëpunim dhe me kërkesë të KfV-së dhe të Ministrisë së Jashtme, me anë të notave verbale me ambasadën gjermane, është vlerësuar se do të ishte më e favorshme

që të denoncohej kjo marrëveshje dhe të vijohej me kalimin e grantit për Ministrinë e Bujqësisë, si garanci për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Eduard Shalsi – A kanë ndonjë gjë për të shtuar përfaqësuesit e Ministrisë së Financave?

Ilir Bejtja – Rrolin e garantit me grandin do ta luajë Fondi i Garancisë së Kredive Rurale. Në rastin e parë, personat që donin financim duhej të kishin garanci kolaterale, vetëm atëherë mund ta përdornin këtë fond, i cili është i butë nga pikëpamja e interesave, por mungesa e garancive kolaterale, sipas kushteve që vendosi banka “Pro Credit”, solli pamundësinë e lëvrimit të fondit.

Ilir Halilaj – Dua të shtoj që Fondi i Garancive të Kredive Rurale, i cili nëpërmjet 3 milionëve të parë ka dhënë rreth 1200 kredi dhe deri më sot fondi është përdorur i gjithi, pra shtesa prej 5 milion eurosh, që do të alokohet mbas shfuqizimit të marrëveshjes “Për efencën e energjisë”, do t’i shtohet fondit të 3 milion eurove, që Fondi ka përdorur me sukses dhe do ta rrisë edhe më tej kapacitetin e këtij Fondi për të alokuar kredi të reja në bujqësi.

Eduard Shalsi – Ndërkohë, kemi një marrëveshje tjetër që do ta shqyrtojmë në ditët në vijim për rifinancimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale që është faza e dytë. A ka të bëjë kjo marrëveshje me këtë?

Ilir Halilaj – Edhe kjo marrëveshje do të shfuqizohet, pra do të shfuqizohen dy marrëveshje dhe pastaj do të propozohet për miratim marrëveshja për alokimin e 5 milionë eurove të Fondit të Kredive të Garancive Rurale.

Eduard Shalsi – Nuk është gati akoma marrëveshja?

Ilir Halilaj – Kjo marrëveshje do të jetë gati mbasi të shfuqizohen dy marrëveshjet, pra shfuqizimi i dy marrëveshjeve është kusht për angazhimin e marrëveshjes së re.

Eduard Shalsi – A keni pyetje të nderuar deputetë?

Florian Mima – E ndihet tërmetin? Më thonë se në katin e katërt ka një krisje e gjithë salla dhe më konfirmojnë se e vetmja ndërtesë në Tiranë që nuk ka pësuar krisje dhe asnjë dëm është Teatri Kombëtar.

Eduard Shalsi – Kalojmë në votimin e projektligjit.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit përfaqësuesve të ministrisë!

Kalojmë te kalendari, i cili është shpërndarë.

A ka ndonjë merak?

Klevis Balliu – Po mbush vitin rikërkesa që bëme në fillim të legjislaturës për referendumin për mbetjet, të cilën e mbani aty dhe nuk e sillni asnjëherë në komision. Ku është?

Përveç çështjes që është sensitive, ky popull kjo Kushtetutë dhe këto ligje bllokohen në mënyrë abuzive në këtë Kuvend, sepse çdo gjë është bërë sipas rregullit, me kërkesë dhe me firma deputetësh, por nuk bëhet dot referendum. Meqenëse më pyete, atëherë fute në kalendar dhe sille për diskutim. Kjo është e turpshme, sepse kështu bëhet këtu, gjendet ngërçi ligjor dhe bllokohet. Siç e gjetët ngërçin ligjor për teatrin, Kushtetuta e parashikon që këtë të drejtë e ka pushtetit vendor, ligji organik i pushtetit vendor parashikon që këshilli bashkiak mund të vendosë me tri të pestat për tjetërsimin e pronës publike, ndërsa ju doni ta kaloni nesër me 36 vota një ligj që tjetërsion pronën publike, që shkatërron historinë dhe që shemb Teatrin Kombëtar. Të gjithë këtë e bëni, sepse e keni zhdukur Gjykatën Kushtetuese, eliminuat edhe Gjykatën e Lartë dhe njerëzit nuk kanë se ku ta përplasnin kokën.

Kjo është paligjshmëri totale. Paligjshmëri që me forcë kartonësh abuzivë, minimale dhe pa rregulla, doni të kaloni nesër një ligj me 36 vota, të cilin po ta fusni në Kushtetutë, do 93 vota dhe për t'u votuar i duhen 84 vota. Çojeni dhe bëjeni procedurën siç e kanë të gjitha ligjet e vendit. Përse doni të bëheni pjesë e kësaj afere edhe ju që jeni në këtë sallë? Kjo është e turpshme. Votuat dje dhe ngritët dorën, e çfarë arritët? Precedenti më i rrezikshëm që ka ndodhur ndonjëherë në Shqipëri ky është. Të shembim teatrin, të tjetërsojmë pronën publike dhe akoma më e rrezikshme se këto është precedenti që po i bëni këtij vendi. Aprovojmë çdo gjë me vendime të thjeshta, si të na teket dhe kur të na teket. Çfarë është kjo? Si nuk ju vjen turp? Është e turpshme, e frikshme dhe ky është skandal. E përse e bëni këtë? Sepse keni shkatërruar Gjykatën Kushtetuese. Ky vend nuk ka rend shtetëror dhe shteti është shkatërruar. Çdo gjë ka marrë fund dhe është skandal. Nëse do të shkonte në Gjykatë Kushtetuese, do të binte për 30 minuta.

Eduard Shalsi – Është shumë e qartë, të vazhdojmë me rendin e ditës.

Fjalën e ka zoti Beqaj

Ilir Beqaj – Diskutimet për teatrin i bëmë dhe pardje dhe besoj se, po t'i marrim minutat, edhe pse nuk është punë peshoreje farmacie, opozita ka qenë më shumë prezente me pyetjet, me deklaratimet dhe me provokimet. Ato debate, besoj se secili nga kolegët e opozitës, mund t'i diskutojnë dhe pardje në mënyrë shteruese.

Së pari, kjo maxhorancë ka 74 vota. Për fat të keq të Shqipërisë opozita është katandisur me kokrra.

E dyta, nëse ka përgjigje për turp, në qeverisjen e mëparshme të PD-së për Teatrin Kombëtar janë avulluar 3 milionë euro, pra kjo qeveria e mëparshme donte të bënte Teatrin te Piramida. Pse? E gjykoj se nuk duhej ta bënte, pra alokoi, 6 milionë, dha 3 milionë, të cilat i mori familja, dhe sot nuk ka asnjë qindarkë. Kështu që këto diskutime për Teatrin i mbyllëm, do t'i diskutojmë nesër në seancë, prandaj le ta votojmë kalendarin, se ia kemi dhënë opozitës të gjithë kohën e mjaftueshme të shprehet.

Eduard Shalsi – Faleminderit!

Tani, e para, mirës se erdhët në komision, se keni ardhur vetëm për teatrin dhe ne prej kohësh kemi dashur të diskutojmë një iniciativë, të ardhur nga një koleg i juaji prej 2-3 muajsh, për të ndryshuar një nen. Unë mendova se do të ishit shqetësuar për këtë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kalendari nuk votohet tani, unë bëra thjesht një konsultë paraprake në lidhje me Konferencën e Kryetarëve. Ju vura në dijeni se ka një shqetësim për ligjin. A e keni lexuar? A e di niqë është këtu apo nuk e keni idenë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ku është? Thuaje ti, se unë flas mbi bazën e këtij projektkalendari.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë, Ilir! Unë nuk lexoj të ketë ndonjë referendum këtu, prandaj po them se duan të tallen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fute pra se bëhet kërkesë, akoma nuk i mësuat dy procedura. A e kuptoni se nuk e fus unë, se duhet të bëhet kërkesë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë, zoti Gurakuqi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sqarohuni me njëri-tjetrin, se unë jam te zyra dhe më thoni kur të kthehem!

Zoti Gurakuqi, meqenëse është hera e dytë që vini në këtë komision dhe herën e parë u ankuat se nuk ju dhashë fjalën, doja thjesht t'ju vija në dijeni se nuk jua dhashë qëllimisht,

madje nuk do t'ia jap fjalën askujt tjetër, i cili flet në komision jashtë çështjeve të rendit të ditës.

Ka një mundësi: depozitohet një kërkesë dhe bëhet një debat apo një diskutim mbi bazën e kësaj kërkesë. Por skenat e neveritshme të komisioneve të tjera nuk kam ndërmend t'i lejoj këtu. Kaq e thjeshtë është historia.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë! Ulu, se e vendos unë kujt ia jap fjalën, nuk e vendos ti nëse ikin apo nuk ikin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund të ketë për kalendarin. Ulu një sekondë!

Po zonja në krah të zotit Gurakuqi kush është?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Qenka deputete! Mirë se erdhët! Është kënaqësi t'ju kemi në komision!

Pra, zoti Gurakuqi, edhe një herë përpara se t'ju jap fjalën. Skenat e komisioneve të tjera, siç pati një fragment këtu, jam i vendosur të mos i lejoj. Situata mund të dalë ndonjëherë jashtë kontrollit për disa sekonda, por jo me orë të tëra.

Sot kemi një rend dite, të cilin pothuajse e përfunduam, pra ishim në mbyllje. Ndërkohë u shfaqët ju dhe ju uroj mirëseardhjen! Herën e kaluar nuk jua dhashë fjalën dhe nuk do t'jua jap, ashtu siç refuzova t'ia jap cilitdo që ngriti dorën atë ditë, sepse ka një procedurë dhe një rregull parlamentar. Nëse doni të bëni objekt diskutimi një çështje, më mirë thoni që në fillim të mbledhjes: “kemi këtë gjë për procedurë”.

Komisioni ka një sekretari, ku depozitohet një kërkesë dhe thuhet: “Dua të ftoj filan titullar”. E kam shumë të vështirë kur shfaqeni në momentin e fundit dhe kërkon fjalën për procedurë. Unë do t'jua jap fjalën, vetëm se kini parasysh këto kërkesa, të cilat nuk janë të miat, por të komisionit. Nëse dilni jashtë rendit të ditës, jam i detyruar t'ju them se nuk është kjo tema për sot. Nuk është në respekt të komisionit të vini pa ditur rendin e ditës dhe pa ditur se çfarë është diskutuar, por për hir të asaj që ju përfaqësoni, po jua jap fjalën për procedurë, por duhet t'i keni parasysh këto gjëra që thashë.

Romeo Gurakuqi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë erdha me gjithë respektin që kam për ju dhe për pjesën e deputetëve, të cilët mendojnë vetë dhe kanë një autoritet personal.

Kërkesa ime sot është e përsëritur dhe lidhet, para së gjithash, me ju dhe me të gjithë pjesën e deputetëve të maxhorancës, të cilët mendojnë vetë dhe kërkoj që të respektohen parlamentarizmi dhe të drejtat e opozitës, të cilat po shkelen sistematikisht. Konkretisht, kemi

disa ditë që diskutojmë në komisionet parlamentare dhe në seancën plenare në lidhje me një problem shumë të rëndësishëm për sa i përket ndjeshmërisë publike për mbrojtjen e pronës publike dhe të identitetit kulturor të Tiranës.

Eduard Shalsi – Zoti Gurakuqi, me të gjithë konsideratën dhe respektin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, në respekt të vetes suaj, mos u bëni pjesë e skenave dhe e personazheve që nuk na nderojnë, të paktën ne të dy!

Si deputet i ri, ju informoj se ka disa rregulla dhe procedura.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, me vjen keq se nuk është çështje moshe, por si deputet i ri që jeni mua më duhet t'ju rikujtoj se ka disa procedura parlamentare.

(Mungese incizimi)

MBYLLET MBLEDHJA